



**AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË**

Tiranë, më 10.03. 2025
Nr. 442 Prot.



**AGJENCIA E MENAXHIMIT
TË BURIMEVE UJORE**

Tiranë, më 10.3. 2025
Nr. 444 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

dhe

AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Për zhvillimin e veprimtarive me interes të përbashkët lidhur me kërkimin shkencor, projektet, ekspertizat dhe oponencat tekniko-ligjore në fushën e gjeoinxhinierisë dhe gjeoshkencave, pasurive ujore dhe mjedisit

E lidhur sot, më datë 10.03. 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë - Tiranë, ndërmjet palëve:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH) me adresë Sheshi "Fan. S.Noli", nr. 7, Tiranë, përfaqësuar nga kryetari, akad. Skënder Gjinushi

dhe

Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) me adresë: Bulevardi "Zhan D'Ark", prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, përfaqësuar nga drejtoresha e përgjithshme, znj. Anila Shehu.

Preambul

Duke ditur se, **Akademia e Shkencave të Shqipërisë** është institucioni publik më i lartë që përfaqëson dhe mbart vlerat më të mira të shkencës, të krijimtarisë dhe bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh;

Duke qenë të përgjegjshëm për rolin e Akademisë për të këshilluar e ndihmuar me rekomandime, ekspertiza e opoenca qeverinë dhe institucionet qendrore, për aspekte të rëndësishme të kërkimit shkencor, të formimit të specialistëve të lartë dhe të planifikimit të projekteve të së ardhmes;

Duke vlerësuar rëndësinë e rolit të **Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore**, e cila ushtron aktivitetin e saj në fushën e burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë, dhe ka statusin juridik si një nga *organet kombëtare të administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore*;

Duke njohur rëndësinë e madhe ekonomike të pasurive ujore dhe rëndësinë e studimeve gjeoinxhinierike, kimike, biologjike dhe mjedisore të tyre;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë në realizimin e këtij bashkëpunimi për të përmbushur dhe angazhimet në kuadër të integritetit në BE;

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është rritja e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet dy institucioneve në fusha me interesa të përbashkëta, duke nxitur dhe mbështetur veçanërisht bashkëpunimin ndërmjet AMBU-së dhe njësive të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave, atë të Njesisë së gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive dhe Njesisë së "Pasurive ujore".
2. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, palët angazhohen të ndërmarrin studime dhe projekte të përbashkëta, kur e gjykojnë të përshtatshme, në fushën e gjeoinxhinierive dhe gjeoshkencave, pasurive ujore dhe mjedisit në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim lehtësimin e procedurave për kontributet institucionale në raste bashkëpunimesh, si dhe për të hapur rrugë për bashkëpunime të mëtejshme.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet palëve lidhur me studime, projekte, ekspertiza, opoenca teknike e ligjore, brenda fushës së përgjegjësisë së ASHSH-së dhe AMBU-së.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet duke u bazuar në:

- a) Ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 4, pika 4.
- b) Ligjin nr. 29/2024 “Për burimet ujore”, neni 9, shkronja “gj”, neni 16, pika 2, neni 133, pika 4.
- c) Statutin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Neni 4

Drejtimit e bashkëpunimit

Palët nëpërmjet kësaj marrëveshjeje angazhohen:

1. ASHSH merr përsipër të hartojë projekte dhe kontribuojë nëpërmjet ekspertizave dhe opinionave të një niveli të lartë shkencor si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe ajo ligjore.
2. AMBU merr përsipër që për projektet që zhvillon me fokus në fushën e gjeoinxhinierive dhe gjeoshkencave, pasurive ujore dhe mjedisit, të bashkëpunojë sipas nevojës dhe kur e gjykon të përshtatshme me specialistët e ASHSH-së në fazat e përgatitjes, zbatimit, si dhe hartimit dhe publikimit të rezultateve.
3. ASHSH dhe AMBU caktojnë koordinatore përgjegjës për ndjekjen e projekteve konkrete, si dhe caktojnë staf teknik si pjesë e grupeve të punës me detyra të përcaktuara, në fillim të çdo aktiviteti/projekti.
4. ASHSH dhe AMBU për zbatimin e projekteve të përbashkëta, të cilat përfshijnë kërkimin shkencor në fushat e sipërpërmendura angazhohen që çdo procedurë do të realizohet në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme të palëve.
5. ASHSH dhe AMBU, bazuar në aktivitetet/projektet e përbashkëta angazhohen të organizojnë aktivitete tekniko-shkencore dhe të publikojnë rezultatet e kërimit shkencor në revistën shkencore të ASHSH-së, “JNTS”, ose në revista të tjera të specializuara.
6. ASHSH dhe AMBU mund të ftojnë specialistë të institucioneve respektive për të marrë pjesë në konferenca, simpoziume dhe veprimtari të tjera shkencore, për konsultime, ekspertiza dhe mbajtje ligjëratah.
7. Palët bien dakord që rezultatet e kërkimeve si dhe i gjithë informacioni i rëndësishëm dhe njohuritë e fituara prej projekteve të përbashkëta do të shpërndahen e publikohen, ose do të mbahen konfidenciale, në përputhje me termat specifike të caktuara nga të dyja palët për projekte të veçanta. Kjo mënyrë veprimi dhe mbrojtja e pronësisë intelektuale duhet të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 5

Efektet financiare

1. Në rast bashkëpunimi për projekte kombëtare ose ndërkombëtare burimet e nevojshme financiare do të sigurohen nga fondet e vëna në dispozicion për atë projekt nga financuesi, ku secila palë merr përgjegjësitë dhe angazhimet e veta me shkrim.

2. Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që palët kanë në dispozicion.

Neni 6

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre, sipas kushteve të paracaktuara. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike.
2. Shkëmbimi i informacioneve do të kryhet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Vlerësimi i zbatimit të marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkarisht funksionimin e bashkëpunimit në mbështetje të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së raporteve vjetore pranë titullarëve të Palëve.
2. Raporti periodik përmban, krahas të dhënave për mënyrën e zbatimit të marrëveshjes, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 8

Ndryshimi i marrëveshjes

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohen ose të plotësohen me miratimin e dy Palëve. Ndryshimet dhe plotësimet bëhen me shkrim, me pëlqimin paraprak të palëve.

Neni 9

Përfundimi i marrëveshjes

1. Marrëveshja lidhet për një afat 3 (tre) - vjeçar, por mund të përfundojë në çdo kohë me kërkesën me shkrim të secilës palë, 30 ditë përpara përfundimit.
2. Deri në përfundim të kësaj marrëveshjeje, palët u përmbahen kushteve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, për sa i përket informacionit, shërbimeve të ofruara dhe dokumentacionit të shkëmbyer, përpara datës së përfundimit.
3. Pavarësisht përfundimit të marrëveshjes, kontratat e nënshkruara zbatohen deri në përfundimin e tyre.

Neni 10

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë trevjeçare.

Neni 11
Dispozitat e fundit

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, nga dy për secilën palë, në gjuhën shqipe, me vlefshmëri të barabartë përmbajtësore.

**PËR AKADEMINË E SHKENCAVE
TË SHQIPËRISË**

KRYETAR

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI



**PËR AGJENCINË E MENAXHIMIT TË
BURIMEVE UJORE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANILA SHEHU

